



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

Nr. 1314 Prot.

Tiranë, më 21.2.2014

URDHËR

NR. 43, DATË 21.2.2014

“PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË”

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”, të ndryshuar, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.173, datë 07.03.2003 “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.545, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit” dhe Vendimit nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Z. Avni MESHI të lirohet nga detyra e Drejtorit të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL)
2. Marrëdhëniet financiare dhe të detyrës për Z. Avni MESHI ndërpriten më datë 21/02/2014.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhëri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në MAS.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

